

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN

“PËR KËSHILLAT MBIKËQYRËS TË SHOQËRIVE AKSIONARE SHTETËRORE”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore” hartohet në kuadër të reformimit dhe modernizimit të mëtejshëm të qeverisjes korporative në shoqëritë tregtare shtetërore, me synim forcimin e profesionalizmit, transparencës, meritokracisë, integritetit dhe efektivitetit të organeve mbikëqyrëse të këtyre shoqërive.

Projektakti synon krijimin e një kuadri të ri dhe të konsoliduar rregullator për organizimin, përbërjen, përzgjedhjen, funksionimin dhe mbikëqyrjen e këshillave mbikëqyrës të shoqërive tregtare shtetërore, në përputhje me standardet bashkëkohore të qeverisjes korporative dhe rekomandimet ndërkombëtare në këtë fushë.

Nëpërmjet këtij projektvendimi synohet:

- forcimi i rolit të këshillave mbikëqyrës në shoqëritë tregtare shtetërore;
- garantimi i përzgjedhjes transparente dhe meritokratike të anëtarëve;
- rritja e pavarësisë dhe profesionalizmit të këshillave mbikëqyrës;
- forcimi i mekanizmave të integritetit dhe menaxhimit të konfliktit të interesit;
- standardizimi i procedurave të përzgjedhjes dhe vlerësimit të anëtarëve nëpërmjet Komisioneve të Përhershme të Emërimit;
- rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës në funksionimin e shoqërive tregtare shtetërore;
- përafrimi me parimet dhe standardet e OECD dhe SIGMA.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi i mësipërm nuk është parashikuar në programin analitik të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, por është në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe me orientimet e Vendimit nr. 621, datë 10.10.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumentit të politikës ‘Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027’, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian ‘Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor’”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Në kuadër të objektivit për të garantuar që të gjithë anëtarët e rinj të bordeve të shoqërive tregtare shtetërore të emërohen nëpërmjet procedurave transparente dhe të bazuara në meritë, si dhe në funksion të forcimit të standardeve të qeverisjes korporative në këto shoqëri, zbatimi i deritanishëm i vendimit nr. 570, datë 3.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive tregtare shtetërore”, të ndryshuar, ka evidentuar nevojën për një rishikim të plotë të kuadrit rregullator ekzistues, me qëllim forcimin e pavarësisë, profesionalizmit dhe efektivitetit të këshillave mbikëqyrës. Në praktikë janë konstatuar mangësi lidhur me:

- mungesën e procedurave të standardizuara për përzgjedhjen e anëtarëve;
- numrin e anëtarëve të pavarur;
- mungesën e mekanizmave të strukturuar për monitorimin dhe vlerësimin e performancës së këshillave mbikëqyrës;
- mungesën e strukturave të specializuara dhe të përhershme që të garantojnë një proces profesional, transparent dhe të bazuar në meritokraci për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të këshillave mbikëqyrës.

Në këtë kuadër, projektvendimi parashikon ngritjen e Komisioneve të Përhershme të Emërimit pranë institucioneve përgjegjëse, të cilat do të organizojnë procedurat e hapura të aplikimit, vlerësimin dhe përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të këshillave mbikëqyrës.

Projektakti përcakton kritere të qarta për statusin e anëtarit të pavarur, kufizime për funksionarët politikë dhe rastet e konfliktit të interesit, si dhe rregulla të detajuara mbi mandatin, shpërblimin, raportimin dhe vlerësimin e performancës së këshillave mbikëqyrës.

Gjithashtu, projektvendimi forcon transparencën dhe përgjegjshmërinë në funksionimin e këshillave mbikëqyrës, nëpërmjet detyrimit për raportim periodik dhe publikim të informacionit përkatës.

Efektet e pritshme të projektaktit konsistojnë në:

- përmirësimin e qeverisjes korporative në shoqëritë tregtare shtetërore;
- rritjen e cilësisë së mbikëqyrjes dhe administrimit të shoqërive;
- forcimin e integritetit dhe profesionalizmit në organet mbikëqyrëse;
- rritjen e besueshmërisë dhe transparencës së proceseve të emërimit;
- përmirësimin e performancës së shoqërive tregtare shtetërore dhe mbrojtjen më efektive të interesit publik.

Ky projektvendim u gjenerua në sistemin e mbivendosjes ligjore dhe pas kërkimit rezulton se ky projektakt nuk ka mbivendosje ligjore. Akti i propozuar nuk ka për qëllim ndërmarrjen e proceseve të derregullimit dhe nuk sjell thjeshtim, reduktim apo eliminim të procedurave administrative ekzistuese.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 8 të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

Projektvendimi është në përputhje me rendin juridik të brendshëm dhe nuk bie në kundërshtim me dispozitat kushtetuese apo me legjislacionin material dhe procedural në fuqi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Projektakti nuk synon përafrim të drejtpërdrejtë me *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi përcakton një kuadër të ri të plotë rregullator për organizimin, përbërjen, përzgjedhjen, funksionimin dhe mbikëqyrjen e këshillave mbikëqyrës të shoqërive tregtare shtetërore, me qëllim forcimin e standardeve të qeverisjes korporative dhe rritjen e rolit mbikëqyrës të këtyre organeve.

Në fillim, projektakti përcakton numrin e anëtarëve të këshillave mbikëqyrës në përputhje me legjislacionin në fuqi për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare, duke parashikuar që numri konkret i anëtarëve të përcaktohet në statutet përkatëse të shoqërive. Njëkohësisht, rregullohet procedura e emërimit të anëtarëve të këshillave mbikëqyrës, duke përcaktuar rolin e institucioneve përgjegjëse dhe të Komisioneve të Përhershme të Emërimit në procesin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve.

Projektvendimi parashikon që shumica e anëtarëve të këshillave mbikëqyrës të jenë anëtarë të pavarur dhe përcakton kriteret që duhet të plotësojnë këta anëtarë, duke përfshirë mungesën e marrëdhënieve kontraktuale me shoqërinë, mungesën e konfliktit të interesit, mosushttrimin e funksioneve politike aktive dhe përmbushjen e standardeve të integritetit dhe profesionalizmit. Gjithashtu, përcaktohet se kryetari i këshillit mbikëqyrës zgjidhet nga radhët e anëtarëve të pavarur dhe se përbërja e këshillit duhet të respektojë parimin e barazisë gjinore.

Projektakti rregullon në mënyrë të posaçme çështjet që lidhen me konfliktin e interesit, duke vendosur detyrimin për deklaram të vazhdueshëm të mungesës së konfliktit të interesit dhe paanshmërisë nga ana e anëtarëve të këshillave mbikëqyrës. Parashikohet gjithashtu verifikimi periodik i këtij statusi dhe masat që merren në rastet e konfliktit të interesit apo shkeljeve të rënda.

Projektvendimi përcakton mandatin e anëtarëve të këshillave mbikëqyrës, të drejtën e rizgjedhjes dhe kufizimet për emërimet e shumëfishta, me qëllim garantimin e funksionimit efektiv dhe shmangien e përqendrimit të funksioneve mbikëqyrëse në të njëjtët individë.

Projektvendimi përcakton gjithashtu kriteret profesionale që duhet të plotësojnë kandidatët për anëtarë të këshillave mbikëqyrës, duke përfshirë përvojën në drejtim dhe menaxhim, njohuritë në financë, qeverisje korporative, menaxhim risku dhe kompetenca sektoriale sipas fushës së veprimtarisë së shoqërisë.

Në vijim, projektakti rregullon mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të këshillave mbikëqyrës, duke përcaktuar kufijtë maksimalë të shpërblimit sipas kategorisë së shoqërive tregtare shtetërore dhe statusit të anëtarëve, si dhe duke sanksionuar që efektet financiare të përballohen nga vetë shoqëritë tregtare.

Projektvendimi parashikon detyrime të qarta për mbledhjet periodike të këshillave mbikëqyrës, raportimin pranë përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, realizimin e vetëvlerësimit vjetor dhe kryerjen e vlerësimeve të jashtme periodike për shoqëritë strategjike. Gjithashtu, përcaktohet detyrimi për hartimin dhe publikimin e raporteve vjetore mbi performancën e shoqërisë, veprimtarinë e këshillit dhe shpërblimet e anëtarëve.

Një pjesë e rëndësishme e projektaktit lidhet me ngritjen dhe funksionimin e Komisioneve të Përhershme të Emërimit pranë institucioneve përgjegjëse, të cilat do të jenë përgjegjëse për organizimin, administrimin dhe vlerësimin e procedurave të përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të këshillave mbikëqyrës të shoqërive tregtare shtetërore. Në këtë kuadër, projektvendimi parashikon ngritjen e tre komisioneve të veçanta: pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë; pranë ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë; si dhe pranë agjencisë përgjegjëse për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore.

Komisioni i Përhershëm i Emërimit pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë do të jetë përgjegjës për vlerësimin e kandidatëve për këshillat mbikëqyrës të shoqërive tregtare shtetërore në pronësi të institucioneve qendrore, me përjashtim të shoqërive në pronësi të ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, si dhe atyre në pronësi të organeve të vetëqeverisjes vendore. Ky komision do të përbëhet nga 4 anëtarë të pavarur, 1 përfaqësues të nivelit të lartë drejtues me rotacion nga ministria që zhvillon politikat sektoriale, si dhe 1 përfaqësues të nivelit të lartë drejtues nga ministria përgjegjëse për ekonominë.

Komisioni i Përhershëm i Emërimit pranë ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë do të jetë përgjegjës për vlerësimin e kandidatëve për këshillat mbikëqyrës të shoqërive tregtare shtetërore në sektorin e infrastrukturës dhe energjisë. Ky komision do të përbëhet nga 4 anëtarë të pavarur, 1 përfaqësues të nivelit të lartë drejtues nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë dhe 1 përfaqësues të nivelit të lartë drejtues nga ministria përgjegjëse për ekonominë.

Komisioni i Përhershëm i Emërimit pranë agjencisë përgjegjëse për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore do të jetë përgjegjës për vlerësimin e kandidatëve për këshillat mbikëqyrës të shoqërive

tregtare në pronësi të organeve të vetëqeverisjes vendore. Ky komision do të përbëhet nga 4 anëtarë të pavarur, 1 përfaqësues të nivelit të lartë drejtues nga ministria përgjegjëse për ekonominë dhe 1 përfaqësues me rotacion nga bashkia që ushtron të drejtat e pronarit për shoqërinë përkatëse.

Kryetarët e komisioneve zgjidhen nga radhët e anëtarëve të pavarur me shumicë të thjeshtë votash.

Gjithashtu, projektakti përcakton kategoritë e personave që nuk mund të emërohen anëtarë të këshillave mbikëqyrës apo të komisioneve të përhershme të vlerësimit, duke përfshirë funksionarët politikë, drejtuesit e ndërmarrjeve shtetërore, personat në konflikt interesi dhe punonjësit që ushtrojnë funksione auditimi.

Në dispozitat përfundimtare dhe kalimtare, projektvendimi përcakton shtrirjen e zbatimit të tij për të gjitha shoqëritë tregtare shtetërore duke përfshirë dhe shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, energjisë elektrike dhe gazit natyror, si dhe parashikon procedurat për vlerësimin e anëtarëve ekzistues të këshillave mbikëqyrës. Gjithashtu, shfuqizohet vendimi nr. 570, datë 3.10.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive tregtare shtetërore”, i ndryshuar.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha institucionet shtetërore qendrore dhe vendore që kanë në pronësi shoqëri tregtare shtetërore, si dhe agjencia përgjegjëse për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga ministria përgjegjëse për ekonominë, në kuadër të procesit të reformimit të qeverisjes korporative në shoqëritë tregtare shtetërore dhe forcimit të standardeve të transparencës, profesionalizmit dhe meritokracisë në përbërjen e këshillave mbikëqyrës.

Ky projektvendim është dakordësuar më datë 02.06.2026 me ekspertët e SIGMA, në përputhje me rekomandimet dhe standardet ndërkombëtare për qeverisjen e ndërmarrjeve shtetërore, në mbështetje të udhëzimeve të OECD-së për Qeverisjen Korporative të shoqërive në pronësi të shtetit.

Gjithashtu, nëpërmjet komunikimeve elektronike, ministrinë e linjës kanë përcjellë listën e shoqërive tregtare shtetërore për të cilat ushtrojnë tagrin e pronarit dhe të cilat deri më tani kanë zbatuar vendimin nr. 570, datë 3.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”, të ndryshuar.

Në kuadër të procesit të bashkërendimit institucional, projektvendimi i përcillet për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së

Mbrojtjes, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor, si dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, si institucione që kanë në pronësi shoqëri tregtare shtetërore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektakti parashikon efekte financiare që lidhen me funksionimin e Komisioneve të Përhershme të Emërimit dhe sekretariateve teknike pranë institucioneve përgjegjëse ku do të ngrihen këto komisione. Në zbatim të projektvendimit, shpërblimi vjetor për funksionimin e një Komisioni të Përhershëm të Emërimit parashikohet të jetë rreth 5,400,000 (pesë milionë e katërqind mijë) lekë në vit.

Duke qenë se projektakti parashikon ngritjen e 3 (tre) Komisioneve të Përhershme të Emërimit, kostoja totale vjetore për funksionimin e tyre parashikohet të jetë rreth 16,200,000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e dyqind mijë) lekë.

Gjithashtu, projektakti parashikon ngritjen e sekretariateve teknike mbështetëse pranë secilit komision. Sekretariati teknik përbëhet nga 3 (tre) anëtarë për çdo komision, të cilët përfitojnë shpërblim mujor në masën 25,000 (njëzetë e pesë mijë) lekë secili. Në këto kushte, kostoja vjetore për një sekretariat teknik parashikohet të jetë 900,000 (nëntëqind mijë) lekë, ndërsa për 3 (tre) sekretariate teknike kostoja totale vjetore parashikohet të jetë 2,700,000 (dy milionë e shtatëqind mijë) lekë.

Në total, efektet financiare vjetore për funksionimin e Komisioneve të Përhershme të Emërimit dhe sekretariateve teknike mbështetëse parashikohen të jenë rreth 18,900,000 (tetëmbëdhjetë milionë e nëntëqind mijë) lekë.

Këto efekte financiare do të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2026 i institucioneve pranë të cilave ngrihen Komisionet e Përhershme të Emërimit, konkretisht nga ministria përgjegjëse për ekonominë, ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë dhe agjencia përgjegjëse për mbështetjen e vetëqeverisjes vendore.

Efektet financiare për shpërblimin e anëtarëve të këshillave mbikëqyrës përballohen nga vetë shoqëritë tregtare shtetërore dhe nuk sjellin efekte në buxhetin e shtetit.

